

20222363427

## СОБРАНИЕ НА РЕПУБЛИКА СЕВЕРНА МАКЕДОНИЈА

### L I G J PËR PLOTËSIMIN E LIGJIT TË MBROJTJES SHËNDETËSORE

#### Neni 1

Në Ligjin e Mbrojtjes Shëndetësore (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë numër 43/12, 145/12, 87/13, 164/13, 39/14, 43/14, 132/14, 188/14, 10/15, 61/15, 154/15, 192/15, 17/16, 37/16 dhe 20/19 dhe Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut numër 101/19, 153/19, 180/19, 275/19, 77/21, 122/21, 178/21 dhe 150/22), në nenin 73, pas paragrafit (5) shtohet paragrafi i ri (6), si vijon:

“(6) Institucioni Shëndetësor Publik - Shtëpia e Shëndetit Shkup, përveç veprimtarive të shtëpisë së shëndetit për rajonin për të cilin është formuar, mund të kryejë edhe veprimtari, ekskluzivisht për vlerësim funksional të fëmijëve dhe të rinjve me gjendje të prekur shëndetësore deri në moshën 26 vjeçare, në selinë e vet dhe në njësitë e brendshme organizative, si dhe në territorin e Republikës së Maqedonisë së Veriut në ekipet profesionale për vlerësim funksional të fëmijëve dhe të rinjve me gjendje të prekur shëndetësore deri në moshën 26 vjeçare në Strumicë, Shtip, Veles, Manastir, Gostivar, Ohër, Kumanovë dhe Dellçevë.”.

#### Neni 2

Autorizohet Komisioni Juridik Ligjvënës i Kuvendit të Republikës së Maqedonisë së Veriut të përcaktojë tekst të konsoliduar të Ligjit të Mbrojtjes Shëndetësore.

#### Neni 3

Ky ligj hyn në fuqi në ditën e botimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut.